



FOTO: ZHVILLIMI I EKO-TURIZMIT NË ALPET BALLKANIKE (QENDRA PËR MBROJTJEN DHE HULUMTIMIN E ZOGJVE – MAL I ZI)

PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT BULETINI

IPA Programeve të Bashkëpunimit
ndërkufitar Mal i Zi - Shqipëri dhe Mal
i Zi - Kosovë 2014- 2020

Gusht 2020

PËRMBAJTJA

Edicioni i tetë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë* 2014-2020.

Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

Programi IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socioekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Programi IPA BNK Mal i Zi- Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

* Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

- »» Rritja e punësimit të grave duke përdorur potencialin bujqësor të dy vendeve.....2
- »» Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri.....3
- »» Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë5

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 dhe nuk paraqet domodoshmerisht mendimet e Bashkimit Evropian.

Bashkimi Evropian

European Union



Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian



MNE – ALB

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI – SHQIPËRI 2014-2020



MNE – KOS

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI – KOSOVË 2014-2020

CBC ZOOM

Rritja e punësimit të grave duke përdorur potencialin bujqësor të dy vendeve

Projekti "Pjesa Femërore" e Cilësisë përfundoi në Tetor 2019 dhe u zbatua nga Komuna e Ulqinit, Grupi Monitorues Ulqin - MogUL, Qendra UET dhe Komuna e Mirditës. Grupi i synuar i projektit ishin gratë e papunësuar që jetojnë në komunitetet rurale, biznese (veçanërisht hotele, restorante, tregje) si dhe autoritetet lokale. Kapacitetet e grave nga zonat rurale të Ulqinit dhe Mirditës u ngritën përmes trajnimeve të ndryshme, manualeve, vizitave studimore dhe punëtorive. E gjithë kjo u bë me qëllim që t'i pajisë ata me aftësitë e nevojshme dhe të përdorin potencialin bujqësor të dy vendeve fqinje. Pas kësaj, u organizuan dy panire promovuese dhe kjo përfaqëson një aktivitet që partnerët e projektit dëshirojnë të vazhdojnë në të ardhmen..

Menaxherja e projektit të projektit **Vjollca Lika-Çobaj** është e kënaqur me rezultatet dhe ajo është e mendimit se "në kuadër të projektit janë arritur një larmi rezultatesh të cilat janë të dukshme edhe sot, siç janë kapacitetet ekzistuese të grave pjesëmarrëse, rritja e mbështetjes nga institucionet përkatëse si në nivel lokal ashtu edhe si edhe rritja e mundësive për integrimin e tregut ndërkufitar mes Malit të Zi dhe Shqipërisë sidomos kur flasim për promovimin e produkteve vendore dhe shfrytëzimin e këtyre kapaciteteve në begatimin e ofertes turistike të të dy vendeve".

Ajo theksoi rëndësinë e ndjekjes së rezultateve të arritura dhe theksoi mbështetjen e autoriteteve lokale për të ndihmuar vazhdimin e organizimit të panireve me qëllim të plasimit dhe promovimit të punes së këtyre grave. Për më tepër, ajo deklaroi se në periudhën e ardhshme masat mbështetëse nga qeveritë lokale të të dy vendeve në drejtim të stimulimit të sipërmarrjes së grave do të luajnë një rol të rëndësishëm.



Pas përfundimit të aktiviteteve, pjesëmarrëset e projektit janë organizuar brenda shoqatave të grave dhe tani kanë më shumë mundësi për të përmirësuar pozicionin e tyre.



Sipas pikëpamjes së partnerëve të projektit, mundësitë e krijuara brenda projektit siç janë mundësia për të regjistruar amvisnitë/veprimtarinë e tyre, sot reflektohet në më shumë mundësi për plasim në treg.

E pyetur për rëndësinë e projekteve ndërkufitare, **Lika-Çobaj** është e mendimit se rëndësia e projekteve që adresojnë çështjen e punësimit në rajonin ndërkufitar qëndron në mundësitë e ofruara nga iniciativa të tilla. Ajo thekson se "duke marrë parasysh që këto zona manifestojnë gati të njëjtat problematika dhe popullësia e këtyre zonave ndeshet me të njëjtat sfida dhe kufizime, qasja e përbashkët në këtë rast ndihmon në avancimin e çështjes së punësimit në të dy vendet".

Për të përfunduar, ajo deklaroi se problemi kryesor në lidhje me punësimin është hendeuku midis asaj që kërkon tregu dhe asaj që ofrohet në treg. Çdo lloj iniciativë që synon të zvogëlojë këtë hapsirë, ndikon drejtpërdrejt në rritjen e nivelit të punësimit në dy vendet fqinje.



Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

Kontejnerë dhe ishuj të gjelbërt për komunitetet lokale në Berane dhe Malësi e Madhe

Në kuadër të projektit *Ishujt e Gjelbër*, partnerët e projektit nga komuna e Beranes, VIS Albania, Bashkia Malësi e Madhe dhe CARITAS nga Mali i Zi vazhduan me një seri aktivitetsesh në vitin 2020. Gjegjesisht, *ishujt e gjelbër* janë montuar gjatë gushtit në tetë vende në Beranë. Këto vende përfaqësojnë pikat e para ekologjike për mbledhjen selektive të mbetjeve të këtij lloji në Malin e Zi.



Përmes projektit, kontributi është dhënë në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve në Beranë dhe Malësi të Madhe.

Për më tepër, 32 kontejnerë 1100 litrash janë dorëzuar në Koplik me 11 qershor të vitit 2020 dhe do të jenë pjesë e 8 ishujve të gjelbër ekologjikë që do të ndërtohen në Malësi të Madhe, për mbledhjen e veçantë të mbetjeve në 4 vende, në zonat e Koplikut, Gruemirës dhe Bajzës.



Projekti filloi realizimin në prill të vitit 2018, dhe përfundimi i projektit është planifikuar deri në fund të tetorit të këtij viti.

Ekspozitë online

Muzeu Polimje dhe Agjencia e Zhvillimit Rajonal për Bjelasica, Komovi dhe Prokletije në Mal të Zi, dhe Këshilli Rajonal i Shkodrës dhe Euro Partners në Shqipëri, po zbatojnë bashkërisht një projekt bashkëpunimi ndërkuftar „*Ruajtja e peisazheve kulturore të Malit të Zi dhe të Shqipërisë*“. Në frymen e masave lidhur me COVID 19, Agjencia e

Zhvillimit Rajonal për Bjelasica, Komovi dhe Prokletije në Mal të Zi organizoi një ekspozitë online përmes mediave të tyre sociale. Të gjitha fotografitë e botuara janë nga zona e Polimjes.



Shikoni fotografitë [këtu](#).



Të Rinjtë Malazez dhe Shqiptarë për kulturën e Lule Mjadrës

Komuna e Petnjicës, Organizata e Kombëtare e Prodhuesve të Manaferrave, shkolla e mesme e Petnjicës, shkolla e mesme Profesionale "Ndre Mjeda" dhe OJF COSPE Shqipëri, si partnerë në projektin "Të Rinjtë Malazez dhe Shqiptarë për kulturën e Lule Mjadrës", organizuan aktivitete të shumta për të ndihmuar prodhuesit e rinj vendas të mjadrës në Mal të Zi dhe Shqipëri. Projekti përfundoi me 31 gusht të vitit 2020.



Rezultatet e projektit nga pala malazeze u prezantuan në Radio dhe Televizionin e Malit të Zi. Shikoni video materialin duke klikuar [këtu](#).



Në Shqipëri, pas shpërndarjes së pajisjeve dhe ngritjes së plantazheve, prodhuesit e rinj të mjedrës tashmë kanë korrur frutat e tyre të pare.

Promovohet „Turizmi miqësorë për fëmijët“

Shoqata për prosperitet demokratik - ZID (ADP-Zid) në partneritet me Qendrën "Fëmijët Sot" (QFS) nga Shqipëria në kuadër të aktiviteteve brenda projektit „Turizmi miqësorë për fëmijët në rajonin ndërkufitarë“ hapen faqen e internetit <http://www.childfriendlytourism.com>.



Vebfaqja ofron rekomandime për akomodim miqësor për fëmijë, vende për ushqim dhe pije, shërbime mbi qirramarrjes të makineve dhe mbi aventura.

Video promovuese e turizmit gastronomik në Pukë

Në kuadër të projektit „Kuzhina lokale si ofertë turistike në rajonin ndërkufitar“, u prodhua dhe u publikua një video promovuese e ofertës turistike të Pukës. Gjegjesisht, video pasqyron imazhe të rajonit dhe procesin e përgatitjes së recetave tradicionale duke përdorur produkte organike të zonës së Pukës.

Shikoni videon promovuese të turizmit gastronomik në bashkinë Pukë [këtu](#).



Poashtu lexoni librat e gatimit të publikuara brenda projektit:

Kuzhinierin Gorska trpeza mund ta shkarkoni [këtu](#).

Reçetat nga rajoni i Pukës mund ti shkarkoni [këtu](#).

FAKTE TË SHPEJTA - Faqet e internetit të projekteve

Vizitoni edhe faqet e internetit të promovuara brenda projektit „Kuzhina lokale si ofertë turistike e rajonit ndërkufitar“ <https://www.ruralholiday.me/> dhe <http://www.gastro-puka.com/>.

Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

Dorëzohen pajisjet për reciklim në Plavë dhe Gjakovë

Në kuadër të projektit të „Iniciativa të përbashkëta ndërkufitare për menaxhim më të mirë të mbeturinave” të implementuar nga ndërmarrja e Shërbimeve komunale Plavë në Malë të Zi dhe Kompania Regjionale e Mbeturinave Çabrat – Gjakovë në Kosovë, u ndërtua oborri për reciklim në Plavë. Brenda projektit përfundoi blerja e pajisjeve dhe kontejnerëve për komunën e Plavës.



Videon promovues shikoni [këtu](#).

I2 Space: Dizajnimin grafik për ndërmarrësit

I2 Space trajnimi mbi Dizajnimin grafik për ndërmarrësit u realizua në periudhën nga 8 deri me 10 korrik të vitit 2020 në hapësirat e Qendrës së Kompetencave Podgorica. Trajnimi tre-ditor u organizua në kuadër të projektit „Vetëpunësimi i të rinjve dhe ndërmarrësia sociale”, i cili zbatohet nga Asociacioni për Prosperitet Demokratik – Zid, OJQ Lens, Qendra Liberale Demokratike dhe Qendra për Aftësi Kreative.


Qëllimi i këtij trajnimi ishte njohja e pjesëmarrësve me postulatet themelore të dizajnit grafik, bazat e punës në Photoshop (dhe/ose në programin zëvendësues të tij i cili përdoret falas në internet - www.photopoea.com) në mënyrë që të aplikojnë njohuritë e fituara, përmes pjesës praktike të këtij trajnimi dhe të zhvillojnë konceptin e identitetit vizual të projekteve të tyre për media të shkruara dhe dixhitale.



Brenda këtij projekti do të krijohen dy I2 hapësira (I2 space). Hapësira I2 në Kosovë është në fazën e saj të fundit të formimit. Gjegjësisht, para instalimit të pajisjeve dhe fillimit të trajnimeve, ekipi i projektit mbikëqyri përgatitjet në Hapësirën për Ide dhe Inovacionin "I2space" në Pejë.



Hapësira e krijuar si pjesë e projektit të Bashkimit Evropian përmes IPA Programit të bashëpunimit ndërkufitar Mali i Zi - Kosovë do të mirëpresë të rinjtë nga komunat e Pejës, Istogut dhe Deçanit për të qenë pjesë e komunitetit I2 space.



Kjo hapësirë do të lehtësojë mbështetjen e të rinjve nga rajoni kufitar me Malin e Zi në shkëmbimin e ideve, zhvillimin e prototipave dhe krijimin e ndërmarrjeve fillestare.

Pajisjet e prokuruar për demo fermat dhe demo fushat e vendosura

Në kuadër të projektit „Punësimi në gjelbërim për një të ardhme më të mirë të rajonit ndërkufitar të Malit të Zi dhe Kosovës”, partnerët e projektit zbatojnë aktivitete në komunat e Malit të Zi dhe Kosovës.

Pas procesit të pajisjes së fermave demo dhe përfundimit të trajnimit të 25 fermerëve blegtoralë në komunat e Andrijevics, Beranës dhe Plavës janë mbjellë dy parcela me qëllim të ngritjes së kapaciteteve, me një sipërfaqe prej 4 hektarë jonxhë dhe 3 hektarë misër në zonën rurale të Deçanit.



Shënimi i javës së parandalimit të kancerit të qafës së mitrës

Në kuadër të projektit CARES - Veprimet ndër-kufitare në Sektorin e Shëndetit Riprodhues, FORS Mali i Zi dhe ECMI Kosova kanë realizuar një numër aktivitetesh. Përkatësisht, pasi u përgaditen spotet promovuese në TV dhe mbaroi fushata e gjerë dhe pas shënimit të Tetorit si muajit të rritjes së vetëdijes për kancerin e gjirit dhe Javës së Parandalimit të Kancerit të Qafës së mitrës, janë prodhuar broshurat mbi shëndetin riprodhues. Broshura Zbulimi i hershëm dhe parandalimi i kancerit të gjirit dhe qafës së mitrës është në dispozicion në gjuhën [malazeze](#) dhe [shqipe](#).



Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike

Projekti Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike zbatohet nga Qendra për Mbrojtjen dhe Hulumtimin e Zogjve (CZIP), Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC), Shërbimi i shpëtimit malor të Malit të Zi dhe Shoqëria Bjeshkatore Alpiniste "Pashtriku". Brenda projektit, partnerët e projektit filluan me shënimin e itenareve të alpinizmit në Bjeshkët e Nemuna.



Shënimi i shtigjeve të alpinizmit po bëhet me qëllim të rritjes së sigurisë së turistëve, por edhe promovimit të potencialit turistik të kësaj zone.

Më shumë se 50 km shtigje në masivin që lidh Malin e Zi dhe Kosovën janë aktualisht duke u shënuar. Shtegu ndërkufitar do të marrë gjithashtu hartën e vet dhe do të jetë gati për të mirëpritur turistët.



U organizuan punëtoritë dhe aksionet e pastrimit

Projekti Të bashkuar kundër ndotjes – UAP, të cilin e zbatojnë Komuna e Petnjicës, komuna e Gjakovës, OJQ Let's Do It Peja dhe Qendra për Zhvillim Rajonal – Rozhajë, vazhdojë me aktivitete në zonën ndërkufitare. Gjegjësisht, si pjesë e aktiviteteve të tyre, aksioni i pastrimit të dy deponive ilegale në bashkëpunim me Komunën e Gjakovës dhe K.R.M Çabrati u bë në Ditën Ndërkombëtare të Mjedisit.


Shikoni videon nga aksioni [këtu](#).



Sinjalizimi i shtigjeve ndërkufitare

Projekti „Bjeshkët e Nemuna – destinacion natyror tërheqës” zbatohet nga Agjencia e Zhvillimit Rajonal – Perëndimi (AZHR-Perëndim) dhe Komuna e Pejës në Kosovë dhe Agjencia Rajonale e Zhvillimit për Bjelasicë, Komovi dhe Prokletije dhe Organizata turistike Plavë në anën malazeze.

Gjatë muajit gusht, instalimi i sinjalistikës vazhdoi në terren dhe turistët që do të vizitojnë Pejën dhe Deçanin në Kosovë dhe Plavën, Gucinë, Andrijevicën, Beranen dhe Rozhajën në Mal të Zi do të kenë një ofertë të përmirësuar turistike.




AKTE TË SHPEJTA - Dita Botërore e Mjedisit

Dita Botërore e Mjedisit, e organizuar nga Kolumbia këtë vit, është dita më e njohur për aksionin mjedisor. Që nga viti 1974, ajo festohet çdo vit me datën 5 qershor: duke angazhuar qeveritë, bizneset, personat e famshëm dhe qytetarët për të përqendruar përpjekjet e tyre në çështje alarmante mjedisore.

Këtë vit, tema është biodiversiteti - një shqetësim që është urgjent dhe ekzistencial. Ngjarjet e fundit, nga zjarret në Brazil, Shtetet e Bashkuara dhe Australia deri në shpërthimin serioz të karkalecave në Afrikën Lindore - dhe tani, pandemia globale e sëmundjeve - demonstrojnë ndërvarësinë e njerëzve. (Uebfaqja e Kombeve të Bashkuara).

Notifikim: SPT mbetet në dispozicion të aplikuesëve potencial dhe përfituesve të granteve përmes kanaleve të krijuara të komunikimit, duke marrë parasysh që i gjithë stafi i SPT-së ka punuar vazhdimisht nga shtëpitë e tyre dhe, së fundmi, nga zyrat e tyre në mënyrën e zakonshme. Në rast se keni nevojë për ndihmë ose informacion në lidhje me programet ndërkufitare, na [kontaktoni](#).



» Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



European Integration Office



Ministry of finance
Directorate for Finance and Contracting
of the EU Assistance Funds



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo lokalne samouprave
Ministry of Local Government



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

Sanja TODOROVIC

Drejtuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik
E-mail: sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Maja RADOVIC

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat
E-mail: maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Nikola DJONOVIC

Zyrtar Projekti
E-mail: nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Almir CAUSEVIC

Zyrtar Projekti
E-mail: almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Petar BELADA

Asistent Administrativ
E-mail: petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri
Telefon: + 355 22 80 20 80;

Andi ÇEKAJ

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**

Adresa: Kompleksi PRIME, rruga "Tirana", Hyrja D, kati 5, Zyra nr. 53, Prishtinë,
Kosovë

Gazmir RACI

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org

www.cbc-mne-alb.org | www.cbc-mne-kos.org



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian